

Biografia



E lindur në Prishtinë në vitin 1974. Nesrin Shileku Shala ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, në vitin 2000 në degën Ekonomia e Ndërmarrjes.

Karriera e saj e hershme përfshinte role në sektorin humanitar. Fillimisht ka punuar si Asistente e Financave në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe me pas si Asistente e Financave me Mjekët e Botës.

Në tetor të vitit 2003, znj. Shileku Shala filloi karrierën e saj në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si Ndihmës Mbikëqyrës Bankar. Në nëntor të vitit 2005, u promovua në pozitën Mbikëqyrës Bankar dhe nga janari 2007 deri në gusht 2018, shërbeu si Mbikëqyrëse e Lartë Bankare. Përvoja e saj shtrihet edhe në zhvillimin e kornizës ligjore si dhe harmonizimin e rregulloreve me kornizën e Bazelit, me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përmes disa projekteve të zhvilluara nga BQK si dhe me mbështetjen e organizatave tjera ndërkombëtare si Thesari Amerikan, ECB-së, FMN-së, GIZ, Banka Botërore, USAID. Gjithashtu, ka përfunduar një numër të madh të trajnimeve profesionale në vend dhe jashtë vendit.

Znj. Shileku Shala ishte pjese e projektit për hartimin e kornizës rregullative për Kreditë Hipotekare Rezidenciale dhe Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme dhe njëherësh ndoqi programin e certifikimit për Vlerësimin e Pasurive të Paluajtshme pranë Odës Ekonomike të Kosovës.

Në shtator të vitit 2018, znj. Shileku Shala kaloi në sektorin privat, duke iu bashkuar Raiffeisen Bank në Kosovë si Specialiste e Auditimit të Brendshëm. Aftësitë udhëheqëse të saj u njoën me një promovim në krye të Auditimit të Brendshëm në Raiffeisen Leasing në Kosovë në nëntor të vitit 2020.

Pozita e saj më e fundit ishte Udhëheqëse e Departamentit të Auditimit të Brendshëm në PriBank duke nxitur një kulturë të kontrolleve të brendshme të shëndosha që nga fillimi i operacioneve të PriBank.

Përvoja e saj 15 vjeçare në Bankën Qendrore e kombinuar me suksesin e saj në bankat komerciale (6 vite) e ka pozicionuar atë si një udhëheqëse me vizion strategjik me një kuptim të thellë të sektorit financiar.

Me 24 janar të vitit 2024 me propozimin e Guvernatorit, Bordi i BQK-së ka emëruar znj. Shileku Shala në pozitën e Zëvendësguvernatoreve për Funksionet e Përgjithshme. Në rolin e Zëvendësguvernatoreve për Funksionet e Përgjithshme znj. Shileku Shala shërben edhe si anëtare e Bordit Ekzekutiv të BQK-së.

Është e martuar, nënë e tre fëmijëve dhe jeton në Prishtinë.